



Zolla, osa, eksplozivë – Policia e Kosovës kap sasi të madhe armatimi në veri, Sveçla: Parandaluam sulm terrorist

LAJME

LAJMI I FUNDIT

lajmi.net

Më afër lexuesit.

23/06/2023 21:08

f

tw

link

Ministri i Brendshëm, Xhelal Sveçla ka thënë se Policia e Kosovës ka parandaluar një sulm terrorist, duke kapur dhe sekuestruar një sasi të madhe të armatimit.

Ai ka thënë se armatimi i kapur është identifikuar në një veturë me targa të Beogradit, 100 metra larg Komunës së Zveçanit.

“Falë angazhimit intenziv të njësiteve të specializuara të Policisë së Kosovës dhe informatave/inteligjencës së pranuar, sot është identifikuar një veturë me targa të Beogradit, rreth 100m larg Komunës së Zvecanit, në të cilën janë zbuluar sasi të mëdha të armatimeve, mjeteve eksplozive dhe municioneve të ndryshme, përfshi Zolla, Osa, eksplozivë, armë automatike, sasi e konsiderueshme e municionit, shok-bomba, uniforma dhe çanta ushtarake”, ka thënë Sveçla.

Sveçla ka deklaruar se të gjitha këto mjete ishin me qëllim të realizimit të sulmeve terroriste ndaj qytetarëve dhe institucioneve të Kosovës.

“Të gjitha këto mjete kishin për qëllim dhe shërbejnë për realizim të sulmeve terroriste ndaj qytetarëve dhe Institucioneve të Republikës së Kosovës. Kjo është edhe një dëshmi e radhës që Serbia përmes grupeve dhe organizimeve të tilla synon të destabilizojë vendin tonë. Policia e Kosovës bashkë me të gjitha organet tjera të sigurisë vazhdojnë angazhimet e tyre në parandalimit e cdo akti të mundshëm që synon cënimin e sigurisë së vendit tonë”, ka shkruar tutje ai.

“Ky rast konfirmon informacionet e pranua nga Institucionet e sigurisë së Republikës së Kosovës se gjatë javëve të fundit nga territori i Serbisë janë futur në Kosovë vetura dhe automjete të tjera me armatime ushtarake”, ka shkruar në fund Sveçla.a

Ndërkohë, mediat serbe kanë raportuar se Policia e Kosovës, ka zbarkuar në Zvecan për të bërë arrestime të reja, por këto pretendime i ka mohuar zëvendëskomandanti i Policisë për veriun, Veton Elshani në një deklaratë për Kossev.

“Po hetojmë një makinë që dyshojmë se po bartë materiale të dyshimta”, ka thënë ai.

“Merreni me siguri të plotë që nuk ka arrestime, nuk do ta arrestojmë dikënd. Po kërkojmë një makinë që dyshojmë se po bartë armë”, ka thënë ai për mediumin.



Artikuj të ngjashëm



June 24, 2023

Ekspertët dhe opozita alamarmojnë për tkurrje të punësimit, pushteti e mohon...



June 24, 2023

Ambasada e ShBA-së publikon një video: Sanksionet e kanë zvogëluar aftësinë...



June 24, 2023

Konspiracionisti kosovar: Skënderbeu ka luftuar në emër të Krishtit, kundër myslimanëve...



June 24, 2023

Vrasje në tentativë në Prishtinë



June 24, 2023

Raportohet se janë bastisur zyrat e Wagnerit në Shën Petersburg



June 24, 2023

Policia e Kosovës thërret konferencë të jashtëzakonshme për medie në Mitrovicë...



info@lajmi.net
Tel: +383 49 131 131
Rr. Zenel Salihu nr. 28, zyra nr. 5

RRJETET SOCIALE



Other Links

Fact-Checking Policy
Ethics Policy
Corrections Policy
Ownership & Funding Information
Editorial Team Information